

## KREJT SHOKËT E MI (pjesa 6)

### Si Të Japësh Dhe Të Marrësh Respekt

E sigurt që vetëm këtë javë ke dëgjuar shumë histori që kanë treguar mungesë respekti, në Tiranë dëgjon të tilla: Në linjën Kombinat-Kinostudio u zu njëri me fatorinon. Apo më të rënda, babai vrau birin se kishte prishur 200 mijë lekë në lokal, një burrë vret gruan...

Duket sikur kjo lloj sjellje e ashpër është në rritje.

Bibla e quan: sjellje e pahijshme. Njerëzit po bëhen më abuzues ndaj njëritjetrit, fizikisht dhe me fjalë.

Duket sikur ai respekti normal për njerëzit nuk është më normal. Por nga ana tjetër Bibla thotë:

**1 Korintasve 13:5** “*Dashuria nuk sillet në mënyrë të pahijshme.*” Çfarë është sjellja e pahijshme apo e ashpër?

Është thjeshtë munges respekti për dikë, tregon që “*nuk më bëhet vonë për ty*”. Mendoj vetëm për vete.

Nuk ka rëndësi se çfarë mendon ai tjetri, a e lëndo apo jo, unë kam për të bërë këtë që dua. Sjellja e pahijshme përmbledhet me një fjalë: **Egoizëm**. Bota po bëhet gjithë e më shume egoiste dhe Bibla thotë, “*Dashuria nuk është e ashpër. Nuk sillet në mënyrë të pahijshme.*”

### **Ilaci është: "Nderoni të gjithë." 1 Pjetrit 2:17a**

Me cdo person që të lidh jeta e përditshme: prindërit, vëllain, motrën, burrin/gruan, atë shokun e shkollës që të gërric nervat, atë llafazanin tek puna, madje edhe njerëzit që nuk i njeh, jobesimtarët, ateistët, qeveritarët, kalimtarët—të gjithë. Po pse?

### **Pse Të Sillem Me Respekt Me Të Gjithë?**

#### **a. Sepse Të Gjithë I Ka Bërë Perëndia.**

**Psalmi 8:5** “*Ti e bërë pak më të ulët se Perëndia; dhe e kurorëzove me lavdi dhe me nder.*”

Bibla thotë që njerëzit janë kulmi i krijimit. Madje edhe atë nevrikun, të bezdisurin, atë që ti mendon se është rob koti—Perëndia thotë, “*Ej, atë e kam krijuar unë.*”

Pra, për shkak se të gjithë u krijuam nga i njëjti Perëndi, të gjithë meritojnë respekt.

Ne kemi tendencën të jemi të sjellshëm me persona që i konsiderojmë si më të rëndësishëm. Dhe kemi tendencën që të jemi të ashpër me njerëzit që ne mendojmë se janë më poshtë nivelit tonë.

Por Perëndia thotë, *“Ata janë njerëzit e Mi. Respektoi të gjithë. Ki respekt për kryeministrin dhe për lypësin në rrugë, për kryetarin e Bashkisë dhe për jetimin.”* Perëndia i krijoi të gjithë.

### **b. Sepse Jezusi vdiq për të gjithë.**

**1 Pjetrit 1:18-19** *“... Jeni shpenguar nga mënyra e kotë e të jetuarit... (ai pagoi me) gjakun e çmuar të Krishtit...”*

Kryqi tregon sesa me vlerë i konsideron Perëndia njerëzit. Askush nuk e ka mendjen gjithmonë te ky, kurse Perëndia po. Ai mendoi aq shumë sa dërgoi Jezusi të vdiste në kryq për të. Dhe ama, Jezusi na shikon sesi i trajtojmë të tjerët.

Tek **Mateu 25** thuhet që në kohën e gjykimit, ne do të gjykojemi se si i kemi trajtuar njerëzit e tjerë.

Jezusi tha, *“Isha i sëmurë dhe ti nuk erdhe për vizitë, kisha etje dhe s’më dhe për të pirë, isha i uritur dhe nuk më dhe diçka për të ngrënë, isha në burg dhe ti s’erdhe për të më parë.”* Dhe ne do të themi, *“Zot, kur nuk e paskemi bërë ne një gjë të tillë?”*

Jezusi do të thotë, *“Sa herë që nuk ia keni bërë këtë gjë ndonjërit prej këtyre të vegjëlve, këtë nuk ma bëtë as edhe mua.”* A e shikon sa e rëndësishme është. Jezusi vdiq për të gjithë dhe Perëndia i krijoi të gjithë.

### **c. Sepse tregon që unë e njoh Perëndinë.**

Nga kuptohet dikush nëse është besimtar i Jezusin Krishtit ose jo? Shiko sesi shkon me njerëzit, marrëdhënia me ta.

**1 Gjonit 4:8** *“Ai që nuk ka dashuri nuk e ka njohur Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri.”*

Unë mund të jem shumë i saktë nga doktrina dhe besimit, por nëse s’kam dashuri, nuk ka vlerë.

Jezusi ishte shumë i dashur me njerëzit. Ai i dha dinjitet njerëzve.

Një rast: farisenjtë i sollën një grua që e kishin kapur duke bërë tradhëti bashkshortore dhe e shtynë te këmbët e Jezusit. Ata nga ana e doktrinës ata ishin në rregull, por sjellja e atyre vetë ishte përtokë.

Dhe gjëja e parë që bëri Jezusi ishte që mbrojti dinjitetin e kësaj gruaje. Ai e mbrojti para të gjithëve dhe tha: *“Ai që s’ka mëkatuar le ta gjuajë i pari gurin.”*

Të gjithë u larguan një nga një, pastaj në bisedë personale Jezusi u mor me mëkatin e saj. Shko dhe mos mëkato më. Jezusi respektoi njerëzit më të parespektuar.

Farisenjtë nuk e përballonin dot një gjë të tillë.

Ata thanë për Jezusin, te **Luka 15:2** që ky djalë bënte party me mëkatarët.

Madje ai edhe hante me ta.

Njerëzit më të parespektuar të shoqërisë në kohën e Jezusit ishin: taksa mbledhësit, prostitutat dhe lebrozët. Jezusi i bëri shokë të tre këto grupe njerëzish. I trajtoi me dinjitet dhe respekt.

Atëherë, nëse kjo ishte mënyra sesi Jezusi i trajtonte njerëzit dhe nëse Jezu Krishti është në të vërtetë në jetën time, a nuk duket e llogjikshme që kjo duhet të jetë edhe mënyra sesi unë duhet t'i trajtoj njerëzit e tjerë?

**Po.** Ti mund të hiqesh sikur je besimtar shumë i fortë por, nëse je i pasjellshëm, je i ashpër, je si gjë e egër—nuk je dhe aq besimtar sa thua! Sepse: Dashuria nuk është e ashpër. Dhe ai që nuk ka dashuri nuk e njeh Perëndinë fare.

#### **d. Sepse do të marr atë që do jap.**

**Galatasve 6:7b** “Ç’të mbjellë njeriu, atë edhe do të korrë.”

Ky është parimi i mbjellje—korrjes, e përmendim shpesh. Është ligj jete: Korrja është sipas llojit të farës që mbjell. Atë që thua për të tjerët do e thotë dikush tjetër për ty.

A do ti që të të respektojnë të tjerët? Atëherë fillo ti i pari duke i respektuar ata. Nëse do të të trajtojnë me dashuri, atëherë fillo dhe trajtoji njerëzit me dashuri. Nëse do që njerëzit të buzëqeshin kur të shikojnë ty, fillo ti i pari duke u buzëqeshur. Por nëse je i ashpër me njerëzit, si do të sillen ata me ty? Me ashpërsi. Sepse korrja varet nga mbjellja.

#### **Si mund të marr respekt? Duke e dhënë.**

Bibla thotë, “Dashuria nuk është e ashpër.” Njerëzit që janë të sjellshëm janë përgjithësisht njerëz të gëzuar.

**Fjalët e Urta 11:17b** “Njeriu i mëshirshëm (i mirë), i bën të mirë vetës.”

Sjellja e pahijshme nuk sjell rezultate të mira. Madje edhe tregtarët e dinë këtë gjë, nëse shitësi i dyqanit te lagja jote është i ashpër a do të shkosh më tek ai dyqan?

Ai e di, nëse do që biznesi të ecë, duhet t'i respektojë të gjithë. Ka njerëz që shkojnë të pinë kafe në filan lokal, sepse ka turnin ai çuni i respektueshëm.

#### **Si të sillesh me respekt ndaj njerëzve?**

#### **1. Kur flet me njerëzit, ji me takt, jo vetëm i drejpërdrejtë.**

Po e filloj me fjalët sepse kjo është mënyra e parë sesi njerëzit janë të ashpër me të tjerët, me fjalë.

**Fjalët e Urta 15:4** “Një gjuhë e shëndoshë është një dru i jetës, por gjuha e çoroditur e sfilit shpirtin.”

Kuptimi i vargut ka të bëjë me taktin. Të jesh me takt do të thotë që ti e mendon fjalën para se ta thuash. Ka shumë rëndësi mënyra sesi i thua fjalët. Nëse me të vërtetë do të mësosh në lidhje me miqësitë, sekretin e miqësive efektive është takti. Mëso si t'i thuash gjërat siç duhet. Takti në marrëdhëniet me njerëzit është si vaji për motorin e makinës. Minimizon fërkimet.

Fjalë e urtë: “Mat 7 herë, prit 1 herë.”

Përkufizimi i taktit në Bibël:

**Efesianëve 4:15** “*Thuaje të vërtetën me dashuri.*”

Kur bisedon me njerëzit ki takt, jo vetëm i drejtpërdrejtë.

Ka njerëzit që thonë: ‘*Ore, ti ruhem dajakut, të rrahurës, se për fjalë s’dua t’ia di, le të më thonë ç’të duan.*’

Në fakt fjalët lëndojnë më shumë. Mund të thyesh një dorë por do të shërohet për punë javësh. Por ai që lëndohet emocionalisht, do i duhen vite që të shërohet.

Para se të jesh i sinqertë me dikë, mendo përpara dhe pyet veten, “Përse po e them këtë gjë? A po e them që ta ul poshtë apo që ta ndërtoj më shumë miqësinë time me atë person? Cili është motivi?”

## **2. Kur dikush të shërben, ji i kuptueshëm, jo ankues.**

Ky është një moment kur njerëzit janë të pasjellshëm.

**Luka 6:31** “*Ashtu siç dëshironi që t’ju bëjnë juve njerëzit, po ashtu bëni me ta.*”

A do ti që të të ulin të tjerët? Jo. Ti do që të të kuptojnë. Pra, trajtoi të tjerët ashtu siç do që të të trajtojnë ty.

**Pyetje me spec:** Si i trajton ata që të shërbejnë?

Ky është një test i madh karakteri, mënyra si i trajton kamarierët, shitësin te furra e bukës, te parkimi, lavazhi.

Ka njerëz që sillen shumë ashpër me kamarierët, sikur janë vetëm ata në lokal. Dhe nuk lënë bakshish në fund.

Si i trajton mësuesit, po faturinon, po atë gruan tek fast foodi që po ta vonon suflaqen?

*Ashpërsia është shenjë e njerëzve të dobët, tregon shume dobësi karakteri.*

**Fjalët e Urta 16:21** “*T’urti nga zemra do të quhet i matur, dhe ëmbëlsia e buzëve e shton diturinë.*”

A do që prindërit të të dëgjojnë më shumë, apo shokët? Bibla thotë që njerëzit të dëgjojnë më shumë nëse je i dashur me ta. Askush s’do të më dëgjojë kur unë bërtas. *Mizat kapen më lehtë me mjaltë sesa me uthull.* Sjellja e butë i ndryshon njerëzit, jo ashpërsia.

Vendi më i mirë për ta praktikuar këtë gjë është shtëpia. Shpesh ne jemi më të sjellshëm me personat e panjohur. Sillemi me nerva dhe të acaruar me njerëzit që duam më shumë. Sjellja e mirë tregohet duke bërë gjërat e vogla me dashuri. Ashpërsia mund të prishë martesën. A të kujtohet ty (për ata që janë të martuar) sa i sjellshëm ishe kur fillove të dilje me ate personin që je martuar tani, sa i dashur, sa i kujdesshëm, sa xhentil? Çfarë ndodhi më vonë?

Kur dikush të shërben, ji i kuptueshëm, jo ankues.

### **3. Kur nuk bie dakort me dikë ji i butë, jo gjykues**

Si të krishterë, për mua dhe për ty, ka shumë gjëra ndaj të cilave nuk biem dakort, gjëra që ndodhin, mënyra e jetesës së disa personave, sjellja e tyre. Ka shumë gjëra që unë s'jam dakort fare, fare. Madje ka gjëra që bëjnë të krishterët e tjerë dhe nuk bie dakort. Çfarë duhet të bëj?

Ja çfarë thuhet te Romakëve.

**Romakëve 14:12-13** “*Secili nga ne do t'i japë llogari Perëndisë për veten e vet. Prandaj të mos e gjykojmë më njëri-tjetrin ... mos i vini gur pengese ose skandal vëllait.*”

Duhet t'i kujtoj vetes 2 gjëra kur nuk bie dakort me dikë:

**1. Secili nga ne do i japë llogari Perëndisë për sjelljen e tij. Të gjithë.**

**2. Unë nuk jam Perëndia.** Ata nuk do më japin mua llogari. Një nga mësimet më të mëdha që secili duhet ta mbajë mend është “*Ai është Perëndia—jo unë!*” Njerëzit përreth nuk do të më japin llogari mua, por Perëndisë. Ne mund të kemi pikëpamje të ndryshme në lidhje me gjëra që nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe dhe nuk kemi pse t'i sulmojmë njerëzit që nuk bien dakort me ne.

Ka raste kur të krishterët iu kundërvihen njëri-tjetrit dhe bota qesh me ne kur na shikon lëmsh me njëri-tjetrin. Pse? Dashuria nuk është e ashpër.

**Jakobit 3:16-17** “*Atje ku ka smirë dhe grindje, atje ka trazirë... kurse dituria që vjen nga lart, më së pari është e pastër, pajtuese, e butë, e bindur, plot mëshirë, frute të mira, e paanshme dhe jo hipokrite.*”

Nëse është urtësi që vjen nga Perëndia ka për të qenë miqësore, e butë, pajtuese. Kur 2 të krishterë debatojnë për bindjet e tyre nga ta kuptoj unë se kush ka të drejtë?

\*Urtësia që vjen nga lart është pajtuese, e butë, e paanshme, e pastër, jo shkatërruese, jo gërricëse.

Ka shumë nevoja rreth e qark teje, ka shumë gabime që duhen ndrequr. Ka shumë njerëz që janë në robëri të ndryshme dhe kanë nevojë të çlirohen, (*pijet e ndryshme, vese dhe situata të ndryshme*).

Njerëz të ndikuar nga ide të kota, por që e kanë bazuar gjithë jetën e tyre në këto gjëra dhe kanë nevojë për ndihmë që të ndryshojnë.

Kush janë njerëzit që do bëhen instrumente shërimi të kësaj bote, të këtij vendi? Cilin person mund të përdorë Perëndia?

Personin që di ta thonë të vërtetën me takt. Takt, me kuptimin që nuk do ta lëndojë personin më shumë sesa është i lënduar, por ta ndihmojnë të shërohet duke respektuar aftësitë dhe nivelin e personit tjetër dhe duke e nxitur që t'i marrë vendimet në bazë të së vërtetës që ka dëgjuar.

Ky është personi i krishterë që do përdorë Perëndia, njeri me takt por edhe i guximshëm që e thotë të vërtetën pa patur frikë, pa komplekse. Kjo është mënyra se si do Perëndia që të veprojmë ne kur nuk biem dakort me atë që ndodh përreth nesh: Ai do që të jemi me takt, por edhe të guximshëm.

#### **4. Kur ndan besimin me dikë respektoje dhe mos e kundërshtoj gjithë kohës.**

Ky varg që do të lexoj tani është varg kyç. Sidomos për personat që kanë kontaktin e parë me njerëzit.

**Kolosianëve 4:5-6** *"Ecni me urti ndaj të jashtëmëve ...Të folurit tuaj të jetë gjithnjë me hir, i ndrequr me kripë, që të dini si duhet t'i përgjigjeni gjithsecilit."*

Ji me takt. Shiko se si reagoi Jezusi ndaj njerëzve përreth tij. Ai ishte i dashur, i butë, bujar, i respektueshëm. Fetarët ishin të ashpër me njerëzit, Jezusi krejt e kundërta.

Sa herë që ti ndan Lajmin e Mirë me dikë, përpiku që përgjigja jote t'i përshtatet nevojës që ka ai person, mos u mundo të thuash fjalë të bukura, të tregosh sesa shumë di ti. Fillo me nevojën që ka ai person.

**1 Pjetrit 3:15** *"... Jini gjithnjë gati për t'u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujt do që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju, por me butësi e me druajtje (me respekt)."*

Kur i tregon dikujt për ungjillin, bëje me dashuri, jo që ta dënosh atë tjetrin, duke i thënë se sa i keq është ai dhe se sa shumë ka mëkatuar, por syno që ai të pajtohet me Perëndinë dhe jo të ndihet më keq sesa ç'ndihet.

#### **5. Kur njerëzit janë të pasjellshëm me ty, ti ktheja me të mirë.**

Kur dikush është i ashpër me ty, mos ia kthe me të njëjtën monedhë. Kjo vetëm sa do i hedhë benzinë zjarrit. Ai është reagimi i parë që tenton çdo njeri: *'Je nevrrik ti, prit se nuk më ke parë mua sesa keq bëhem.'*

Por kjo nuk do ta sjellë ndryshim. Ashpërsia nuk rregullon gjë, por mirësia. Bibla thotë,

**Romakëve 12:17** *"Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe, kërkonit të bëni të mirën përpara gjithë njerëzve."*

**Romakëve 12:21** *"Mos u mund nga e keqja, por munde të keqen me të mirën.."*

Dua të të nxis: A nisim një luftë të madhe kundër ashpërsisë, sjelljes së pahijshme? Ndërsa niveli i stresit të njerëzit po rritet; njerëzit po bëhen gjithnjë e më të ashpër.

Sa më të stresuar që të jenë, sa më stresuese do të jetë shkolla ose puna e tyre, aq më të ashpër do të bëhen.

Motoja e tyre po bëhet: *"Ti, shiko punën tënde dhe mos e vrit mendjen sesi janë të tjerët."*

A nisim një revolucion kundër ashpërsisë? Dashuria nuk është e ashpër, ajo është e sjellshme, e pastër, e butë. Një gjë për të cilën do të gjykohet secili është se si i kemi trajtuar njerëzit e tjerë.

Unë dua që **kisha jonë** të jetë kisha me njerëzit më të sjellshëm, në shtëpi, shkollë, punë. Kur të vijë ndonjë i ri në këtë kishë të thotë:

**“Ata i duan të gjithë njëlloj. Nuk ka rëndësi se nga vjen, çfarë ke veshur apo sesi dukesh, ata janë miqësor me secilin. Ata çohen që të ulesh ti, të shërbejnë sikur je vetëm ti në atë vend, nuk ka vend më miqësor sesa aty.”**

Kështu i pëlqen Perëndisë që të jemi ne. Merru këtë javë me këtë gjë, trego dashuri në forma praktike.

Filloje në shtëpinë tënde së pari, me ata që ke rreth teje gjatë ditës.

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.